



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU KUKËS
BASHKIA HAS
Njësia Administrative Golaj

PROJEKT PYLLËZIMI

Fshati: Letaj
Zona kadastrale: 1832
Emri popullor i vendit: Rezervuari Letaj
Ekonomia Pyjore: Helshan
Ngastra/Nënngastra: 13c

PROJEKTUESI

KONTROLLOHET

(KONTROLLI NGA STRUKTURA E PYJEVE NË BASHKI)

MIRATOHET

(MIRATIMI NGA AGJENCIA KOMBETARE E PYJEVE)

JANAR 2025
KAPITULLI I

1. KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME



1.1 Përmbledhje e projektit

Projekti i pyllëzimit në zonën e quajtur Rezervuari Letaj në ekonominë pyjore Helshan ka si qëllim instalimin në rrugë artificiale (nëpërmjet mbjelljes) të bimësisë pyjore (lis, shëlg, lajthi) dhe krijimin e një grumbulli të ri që do të sigurojë përfitime afatgjata për popullsinë lokale. Sipërfaqja që do të pyllëzohet është 2.01 ha (Objekti 1: 1.36 ha dhe objekti 2: 0.65 ha) dhe ka një vlerë të përgjithshme prej ***Hequr nga dokumenti origjinal** (pyllëzime, zëvendësime dhe shërbime kulturore për 2 vjet). Nga pyllëzimi i kësaj sipërfaqeje do të punësohen banorë të zonës duke kontribuar në ekonominë familjare të fshatit Peraj dhe Letaj. Angazhimi i komunitetit lokal në këto punime do të rrisë ndërgjegjësimin e tyre për mbrojtjen e pyjeve dhe mjedisit në përgjithësi.

1.2 Qëllimi i realizimit të projektit

Qëllimi i projektit është rritja e mbulesës pyjore dhe rifitimi i shërbimeve të ekosistemit, duke kontribuar në mbrojtjen e biodiversitetit dhe luftimin e ndryshimeve klimatike, si dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ruajtjen e burimeve ujore, ndërkohë që ofron mundësi ekonomike për komunitetet lokale.

1.3 Objektivat e projektit

Disa nga objektivat e projektit janë si më poshtë:

- Rritja e sipërfaqes pyjore; pyllëzimi me lloje autoktone duke promovuar rritjen e lisit, lajthisë dhe shëlgut krijojnë një ekosistem të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për klimën lokale;
- Përmirësimi i biodiversitetit; këto lloje do të ndihmojnë në mbështetje të biodiversitetit duke ofruar habitat për speciet e tjera të florës dhe faunës;
- Mbrojtja ndaj erozionit të tokës; parandalimi i humbjes së tokës dhe ruajtja e cilësisë së saj;
- Rritja e kapacitetit për fiksimin e karbonit; pjesëmarrja në luftën kundër ndryshimeve klimatike përmes stokimit të dioksidit të karbonit;
- Sigurimi i prodhimeve pyjore drusore dhe jo drusore;
- Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe ujit; rritja e filtrimit natyror dhe ruajtja e ekosistemeve ujore;
- Edukimi dhe angazhimi i komunitetit lokal; organizimi i aktiviteteve për të angazhuar komunitetin në procesin e mbjelljes dhe mirëmbajtjes;
- Monitorimi i shëndetit të bimëve; vendosja e një plani për monitorimin e rritjes dhe shëndetit të bimëve për të siguruar suksesin e projektit.

1.4 Plani i punës



Realizimi i planit të punës varet kryesisht nga kushtet e motit, si edhe faktorë të tjerë. Më poshtë jepet në formë tabelare:

P P	Menaxhimi i Projektit	Koha e realizimit
PP-1	Pastrimi i sipërfaqes së parcelës që do të pyllëzohet	Mars 2025 (6 puntore x 3 dite pune)
Objektivi 1	Përgatitja e sipërfaqes për t'u pyllëzuar	3-5 Mars 2025
Lider i PP	Kompania zbatuese e punimeve	3-5 Mars 2025
Detyrat	D.1.1- Pastrimi i shkurreve, gjembave, barërave të këqija, etj. në 2.01 ha; D.1.2- Përgatitja e piketave; D.1.3- Piketimi i gropave; D.1.4-Përgatitja e 680 kalemave të shëlgut.	3-5 Mars 2025
Rezultatet e pritshme	Objekti i gatshëm për fillimin e punimeve të mbjelljes	5 Mars 2025
PP-2	Hapja e gropave	Mars 2025 (10 puntore x 30 gropat/dite x 9 dite pune)
Objektivi 2	Hapja e 2670 gropave me përmasa 40x40x40 cm dhe mbjellja me kunj e 680 kalemave	6-19 Mars 2025
PP lider	Kompania zbatuese e punimeve	6-19 Mars 2025
Detyrat	D.2.1- Hapja e gropave me dimensione 40 x 40 x 40 cm	6-19 Mars 2025
Rezultatet e pritshme	2670 gropat me dimensione 40x40x40 cm të hapura, gati për mbjelljen e fidanëve	19 Mars 2025
PP-3	Transporti fidanëve nga rruga auto tek objekti pyllëzimit	Mars 2025 (10 puntore x 150 fidanet/dite x 2 dite pune)
Objektivi 3	Transporti i 2670 fidanëve ≥ 2 vjeçarë dhe 680 kalemave në objekt	20-21 Mars 2025
PP lider	Kompania zbatuese e punimeve	20-21 Mars 2025
Detyrat	D.3.1- Transporti me kujdes dhe në kohën e duhur i fidanëve dhe shpërndarja në gropat; D.3.2- Transporti i 680 kalemave shëlgut	20-21 Mars 2025



Rezultatet e pritshme	2670 fidanë dhe 680 kalema të transportuar në objekt, të shpërndarë nëpër gropa dhe gati për mbjellje	21 Mars 2025
PP-4	Mbjellja e fidanëve sipas skemës së çrregullt	Mars 2025 (10 puntore x 60 fidane x 5 dite pune)
Objektivi 4	Përfundimi i mbjelljes së fidanëve në gropa	24-28 Mars 2025
PP lider	Kompania zbatuese e punimeve	24-28 Mars 2025
Detyrat	D.4.1- Mbjellja e 2670 fidanëve me skemë të çrregullt sipas përcaktimit të projektit; D.4.2- Mbjellja me kunj e 680 kalemave shëlgju	24-28 Mars 2025
Rezultatet e pritshme	Pyllëzimi multikulturë i një sipërfaqe prej 2.01 ha me skemë jo të rregullt.	28 Mars 2025
PP-5	Kryerja e shërbimeve kulturore	Qershor-Gusht 2025
Objektivi 5	Kryerja e shërbimeve kulturore në fidanët e mbjellë	Qershor - Gusht 2025; Qershor 2026
PP lider	Kompania zbatuese e punimeve	Qershor - Gusht 2025; Qershor 2026
Detyrat	D.5.1- Prashitja dhe plehërimi i fidanëve D.5.2 –Vaditja e fidaneve	Qershor - Gusht 2025; Qershor 2026 Qershor - Gusht 2025; Qershor 2026
Rezultatet e pritshme	Zënia me sukses e fidanëve të mbjellë dhe realizimi i objektivit për një shkallë zënie mbi 80% e numrit të fidanëve të mbjellë. Vlerësimi do të bëhet bazuar në 2 monitorime në Qershor dhe Shtator.	Qershor 2025/26 Shtator 2025/26
PP-6	Kryerja e zëvendësimeve të 20% të fidanëve të tharë vitin 1-rë pas mbjelljes	Dhjetor 2025
Objektivi 6	Zëvendësimi deri 20% të fidanëve të tharë	Dhjetor 2025
PP lider	Kompania zbatuese e punimeve	Dhjetor 2025
Detyrat	D.6.1 –Rihapja e gropave të fidanëve të tharë	Dhjetor 2025



	D.6.2- Mbjellja e fidanëve	
Rezultatet e pritshme	Zënia e plotë e fidanëve të zëvendësuar	Shtator 2026

KAPITULLI II

STUDIMI I OBJEKTIT TË PLANIFIKUAR PËR PYLLËZIM

2.1 Vendosja gjeografike dhe administrative

Objekti 1 dhe 2, të cilët ndodhen në vendin e quajtur rezervuari Letajbën pjesë në ekonominë pyjore Helshan nëzonën kadastrale 1832, parcela/nënparcela 13c, në Nj. Admin. Golaj, Bashkia Has.

2.2 Kufijtë Natyral

Objekti 1 i planifikuar për pyllëzim kufizohet:

Nga veriu, kufizohet nga rezervuari i ujit Letaj

Nga jugu, kufizohet nga sipërfaqe me bimësi pyjore;

Nga lindja kufizohet nga sipërfaqe me bimësi pyjore;

Nga perëndimi kufizohet me sipërfaqe pyjore dushku.

Objekti 2 i planifikuar për pyllëzim kufizohet:

Nga veriu, kufizohet nga rruga që lidh rrethet Krumë - Tropojë;

Nga jugu, kufizohet me rezervuarin e ujit Letaj;

Nga lindja, kufizohet sipërfaqe me bimësi pyjore;

Nga perëndimi, kufizohet me sipërfaqe me bimësi pyjore.

2.3 Sipërfaqja

Sipërfaqja planifikuar për t'u përshkruar me punime pyllëzimi në të dy objektet është 2.01 ha.

2.4 Rrjeti rrugor dhe largësia nga qendrat e banuara

Objekti 1 dhe 2 ndodhet pranë rrugës auto që lidh fshatrat Letaj dhe Peraj, të Nj. Adm. Golaj, po ashtu ndodhet pranë rrugës kryesore që lidh pikën kufitare të Qafë-Prushit me Krumën dhe Krumën me Tropojën. Distanca nga objekti i pyllëzimit me qendrën e Nj. Ad. Golaj është rreth 7 km, nga qendra e Bashkisë Krumë, 16 km, dhe fshati Peraj, 2 km.

2.5 Gjeomorfologjia, forma e terrenit, gjeologjia



Forma e rielievit është fundshpati me valëzim me pjerrësi maksimale 15%, me shkëmb amnor sedimentar.

2.6 Kundrejtimi

Objekti 1 ka kundrejtim ka kundrejtim Verilindor, ndërsa objekti 2 ka kundrejtim Juglindor.

2.7 Lartësia

Lartësia mesatare mbi nivelin e detit e parcelës është 601 m, lartësia minimale 588 m, lartësia maksimale 613 m.

2.8 Hidrologjia

Rrjeti hidrik përbëhet nga përroi i Skatinës, një numër i konsiderueshëm përroskash që furnizohen me ujë vetëm gjatë sezonit të lagësht dhe rezervuari i ujit Letaj. Në pjesën veriperëndimore të objektit 1 ndodhet një ligatinë me sipërfaqe rreth 0.4 ha ku burimet ujore janë aktive gjatë gjithë vitit.

2.9 Kushtet klimatike

2.9.1 Temperaturat mesatare mujore e vjetore¹




Figura 1. Grafiku i temperaturave mesatare mujore dhe vjetore

Objekti ku do të kryhen punimet bën pjesë në klimën mesdhetare paramalore veriore. Ajo dallohet për verën e freskët dhe dimër të lagësht e të ftohtë me ngrica e dëborë. Temperatura mesatare vjetore arrinë 11.4 °C. Në shpërndarjen mujore të temperaturave vërehet se Janari është muaji më i ftohtë me vlera mesatare zakonisht -4°C deri 4°C. Temperaturat më të larta

¹<https://weatherspark.com/y/85651/Average-Weather-in-Krumbë-Albania-Year-Round#Figures-Rainfall>



takohen gjatë muajit Korrik e Gusht, ku Korriku është muaji më i nxehtë me vlera mesatare të temperaturave 14 °C deri 28°C. Ditët me temperatura nën 0° C variojnë nga 20-30 ditë në vit.

2.9.2 Reshjet mesatare mujore dhe vjetore

Sasia vjetore e reshjeve varion nga 900 -1000 mm/vit. Sasi më e madhe e reshjeve është regjistruar gjatë periudhës Tetor - Mars në sasi mbi 600 mm. Sasi më e vogël e reshjeve është regjistruar gjatë muajit Korrik në sasi 28 mm.




Figura 2. Grafiku i reshjeve mesatare mujore dhe vjetore

Bazuar në të dhënat klimatike dhe pasqyruar në grafikun e mëposhtëm, rezulton se në zonën e studimit kemi 2 muaj thatësirë, konkretisht Korriku dhe Gushti. Identifikimi i muajve të thatësirës tregon se në këta 2 muaj duhet të merren masa për vaditjen dhe plotësimin e nevojave të fidanëve për ujë.






Figura3. Grafiku Gaussen

2.10 Kushtet pedologjike (tipi i tokës dhe karakteristikat e saj)

Toka është e kafenjtë, nëntipi i kuqërremtë ose Calcaro-Chromic Cambisols sipas klasifikimit FAO (1974). Janë toka të maleve të ulëta të zonës së pyjeve të dushkut, të kondicionuara nga klima mesdhetare paramalore e malore. Formohen mbi produktet e alterimit (cipat e kuqërremta) të gëlqerorëve (në zonat me reshje të shumta dhe ndryshueshmëri klimatike midis dimrit dhe verës) dhe silikateve, kryesisht të konglomerateve dhe shtufëve ranorë. Kanë përbërje mekanike subargjilore të rëndë deri argjilore, strukturë kokrrizore granulore të paqëndrueshme dhe reaksion acid (pH nga 4 – 5.5). Janë toka të varfëra në fosfor të asimilueshëm për shkak të përmbajtjes së konsiderueshme të oksideve të hekurit dhe aluminit, fosfori kalon në formën e kripërave të patretshme.

2.11 Bimësia ekzistuese

Bimësia ekzistuese në zonën e projektit përfshin një tokë me bimësi të rrallë me prani të Dëllinjës së kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Shkozës së zezë (*Carpinus orientalis*), Frashërit (*Fraxinus ornus*) Ferrës (*Rubus ulmifolius*) dhe bimësisë barishtore, kryesisht të dominuar nga graminoret (*Poa pratensis*, *Festuca pratensis*, etj). Në një sipërfaqe ligatinore prej 0.4 ha në brendësi të objektit 1 gjendet bimësi tipike e ligatinave.

KAPITULLI III

TEKNIKA E KRYERJES SË PUNIMEVE

3.1 Zgjedhja e llojeve



Në zgjedhjen e llojeve për pyllëzim është marrë parasysh kombinimi i drejtë i tre elementëve kryesorë: a) Qëllimi i pyllëzimit, b) Kushtet e mjedisit dhe c) Veçoritë biologjike të llojeve. Për zgjedhjen e llojeve pyjore jemi bazuar në metodën e *ekologjisë së krahasuar*. Ajo lejon përdorimin e prejardhjeve mbi bazën e krahasimit të kushteve të biologjisë së njohur të llojeve në vendin e tyre me mjedisin, pa marrë në konsideratë aftësisinë e tyre për përshtatje në kushte të reja. Nga krahasimi kushteve ekologjike të stacionit me kërkesat ekologjike të specieve rezulton se objekti ku do të kryhen punimet e pyllëzimit ka kushte të përshtatshme për speciet e propozuara. Speciet e rekomanduara për mbjellje janë:

- | | | |
|----|---|-----|
| 1) | Qarri (<i>Quercus cerris</i>) | 40% |
| 2) | Shelgu i bardhë (<i>Salix alba</i>) | 30% |
| 3) | Lajthi e butë (<i>Corylus avellana</i>) | 30% |

Numri total i fidanëve që do të mbillen është: $2.01 \text{ ha} \times 1667 \text{ fidanë/ha} = 3350 \text{ fidanë}$.

Nga këto, objekti 1 me sipërfaqe $1.36 \text{ ha} \times 1667 \text{ fidanë/ha} = 2267 \text{ fidanë}$; dhe

Objekti 2 me sipërfaqe $0.65 \text{ ha} \times 1667 \text{ fidanë/ha} = 1083 \text{ fidanë}$.

Në rastin e shelgut propozojmë sigurimin e kalemave me gjatësi 25-30 cm të marra nga degët e drurëve në këmbë dhe mbjelljen e tyre në objekt. Kalemats duhet të merren nga drurët e shelgut që rriten pranë vendit të mbjelljes dhe janë në gjendje vegetative shumë të mirë.

3.2 Skema, formula dhe metoda e pyllëzimit

Për realizimin e pyllëzimit do të aplikohet mbjellja me fidanë të llojeve Qarr, Shelg i bardhë dhe Lajthi e butë me moshë 2 vjeçare.

Skema e mbjelljes për shkak të veçorive të terrenit do të jetë e çrregullt, pasi është e pamundur mbjellja me skemë të rregullt.

Formula e mbjelljes do të jetë për objektin 1: **40% Qarr + 30% Shelg i bardhë + 30% Lajthi e butë**; objektin 2: **70% Qarr + 30% Lajthi e butë**.

3.3 Mënyra e përgatitjes së tokës

Përgatitja e objektit për mbjellje përfshin: (i) heqjen e barërave të këqija dhe shkurreve, sidomos në ato zona ku ekziston mundësia për rigjenerim (ii) heqjen e materialeve të padëshirueshme. Këshillohet heqja e vegetacionit konkurrues përpara mbjelljes. Heqja e vegetacionit mund të kryhet me pajisje manuale për heqjen e barit dhe për prerjen e shkurreve apo ferrave. Pas pastrimit të zonës puna do të vazhdojë me piketimin e gropave dhe më pas me hapjen e tyre. Diametri i gropës për mbjelljen e fidanëve duhet të jetë të paktën 1.5 herë më i madh se gjerësia e sistemit rrënjor të një fidani me rrënjë të zhveshura ose diametri i pjesës së poshtme të një qese plastike kur fidanët janë me bukë dheu. Madhësia e gropës për mbjellje është 40 cm x 40 cm x 40 cm. Gjatë hapjes së gropave dheu i sipërm që ka më shumë lëndë organike duhet të vendoset në njërin anë të gropës dhe dheu në pjesën fundore të gropës të



vendoset në anën tjetër. Nëse rrënja e fidanit është shumë e gjatë, ajo duhet të pritët deri në një gjatësi 20-25 cm (sipas thellësisë së gropës së mbjelljes) duke përdorur një mjet të mprehtë. Gjatë hapjes së gropave, dheu i gërmuar do të vendoset i ndarë nga njeri-tjetri (në shtresa), si dhe rekomandohet vendosja e fidanit në qendër të gropës së mbjelljes. Më pas mbushet gropa me dhe. Duhet të sigurohemi që fidani të mbahet drejtë gjatë mbjelljes. Përpara vendosjes së fidanit, gropa duhet të mbushet me dheun me cilësi më të mirë, duke u përdorur për të mbushur hapësirën rreth sistemit rrënjor të fidanit. Në çdo moment, dheu i hedhur duhet të ngjeshet butësisht për të shmangur çdo hapësirë rreth sistemit rrënjor të fidanëve. Ndërsa toka me cilësi më të ulët (më e varfër) përdoret për të mbushur pjesën e sipërme të gropës. Duhet të bëhen dy ngjeshje të dheut, kur gropa mbushet me dheun me cilësi më të mirë bëhet ngjeshja e parë dhe e dyta kur mbushet plotësisht me pjesën e mbetur të dheut. Duhet të kontrollohet niveli i qafës së rrënjës, në mënyrë që pas mbjelljes, qafa e rrënjës të jetë disacentimetra më e lartë se niveli i dheut përreth kërcellit të fidanit. Për të plotësuar nevojat e fidanit për lëndë ushqyese do të përdoret një sasi plehu kimik (DAP) në një sasi prej 50 gramë/fidan gjatë mbjelljes dhe 50 gramë/fidanë gjatë prashitjes së parë që do të kryhet në muajin Qershor.




Figura 4. Mënyra e mbjelljes së fidanit në gropë

Kalemat e Shelgut të bardhë do të përgatiten në afërsi të objektit të mbjelljes, nga drurët në këmbë. Pas përgatitjes së kalemave do të bëhet shtresëzimi i tyre me dhe të përzier me rërë në raportin 50/50 dhe do të mbahen të shtresëzuara deri në momentin e mbjelljes. Mbjellja do të kryhet duke përdorur kunja të përgatitura enkas. Ngulja e kalemit në tokë do të bëhet 20-25 cm dhe pjesa e mbetur jashtë duhet të ketë të paktën një ose dy sytha të padëmtuar. Këshillohet të kryhen shërbimet kulturore për një periudhë 2-vjeçare pas mbjelljes. Nga monitorimi i sipërfaqes së mbjellë në muajt Qershor dhe Shtator do të bëhet verifikimi i shkallës së zënies dhe më pas do të bëhet zëvendësimi i fidanëve të tharë. Për të patur sukses rekomandohet mbrojtja e sipërfaqes së mbjellë nga dhitë e dhentë duke përdorur gardhimin e zonës ose duke vendosur roje.

3.4 Materiali mbjellës

Fidanët duhet të jenë të çertifikuar (me çertifikatë origjine dhe cilësie), brenda standardeve shtetërore.



Bazuar në skemën dhe formulën e pyllëzimit, numri i fidanëve që nevojiten për realizimin e punimeve të planifikuara sipas llojeve është:

Nevojat për fidanë:

Nr.	Lloji	Njësia e matjes	Gjithsej	Nga kjo	
				Pyllëzime	Zëvendësime
1	Qarr	Copë	1998	1665	333
2	Shelg i bardhë	Copë	816	680	136
3	Lajthi e butë	Copë	1206	1005	201

Fidanët do të sigurohen nga fidanishte të liçencuara me bukë dheu në qese plastike ose kontenjerë, që i kanë fidanët të certifikuar dhe me gjëndje vegjetative të mirë dhe që janë të vendosur sa më afër objektit të pyllëzimit dhe në kushte ekologjike të ngjashme. Fidanët pyjorë duhet t'i përgjigjen kushteve teknike të mëposhtme:

- Sistemi rrënjor të jetë i zhvilluar mirë, i plotë, i padëmtuar, pa pjesë të thata.
- Kërçelli të jetë i drunjëzuar, i padëmtuar, i drejtë, i pa bigëzuar, me sytha të pa çelur, të zhvilluar normalisht.
- Gjethet të kenë ngjyrën karakteristike dhe fidani të jetë i pa prekur nga sëmundjet dhe insektet, gjithashtu të jetë i freskët.

Në rastin e Shelgut të bardhë mbjellja do të kryhet me kalema me gjatësi 25-30 cm të marra nga degët e drurëve në këmbë. Kalamat duhet të merren nga drurët që rriten pranë vendit të mbjelljes dhe të jenë në gjendje vegjetative shumë të mirë.

Shelgu i bardhë, Qarri dhe Lajthia luajnë role të rëndësishme në restaurimin e peizazhit pyjor. Shelgu i bardhë, me preferencën për toka të lagështa, ndihmon në stabilizimin e sipërfaqeve të lagështa dhe parandalimin e erozionit, duke krijuar një habitat të përshtatshëm për speciet e tjera. Qarri kontribuon në diversitetin biologjik dhe ofron mbulim të dendur, duke rritur stabilitetin e ekosistemit dhe duke siguruar ushqim për kafshët. Ndërsa Lajthia me frutat e saj, ofron burim ushqimi për shpendët dhe gjitarët, gjithashtu ndihmon në riprodhimin e bimëve të tjera përmes përhapjes së farave. Kombinimi i këtyre tre llojeve ndihmon në ripërtëritjen e ekosistemeve, duke rritur biodiversitetin dhe qëndrueshmërinë e peizazheve pyjore.

3.5 Koha e kryerjes së punimeve

Punimet përgatitore do të kryhen gjatë fillimit të muajit Mars 2025. Fillimisht do të përgatitet toka duke u pastruar nga shkurret, barërat e këqija, etj. dhe më pas do të piketohen gropat.



Hapja e gropave, sigurimi i materialit mbjellës (fidanëve/kalemave) dhe mbjellja do të realizohen gjatë vazhimit të muajit Mars 2025. Në rast të ngricave të tejzgjatura, mbjellja do të shtyhet deri në përfundim të tyre.

3.6 Parashikimi i përqindjes së zënieve për periudhën qershor – shtator

Duke pasur parasysh kushtet e mjedisit dhe mundësinë e dëmtimit të fidanave nga faktorë të ndryshëm, parashikojmë që objekti të ketë një shkallë zënie 80% të numrit të fidanëve të mbjellë. Nëse zënia është poshtë këtij kufiri, atëherë do të ndërhyhet me zëvendësimin e të gjithë fidanëve të tharë. Zëvendësimi i fidanëve të tharë do të bëhet në sezonin pasardhës të mbjelljeve. Kjo do të bëhet në bazë të të dhënave që do nxirren nga verifikimi i zënieve në muajt Qershor dhe Shtator 2025. Sasia e fidanëve që do të zëvendësohen është e njëjtë me numrin e atyre që janë tharë.

3.7 Shërbimet kulturale dhe mbrojtja (ruajtja)

Për të ndihmuar zhvillimin sa më të mirë të fidanëve dhe sigurimin e një përqindjeje sa më të lartë në zënien e tyre, është e domosdoshme kryerja e shërbimeve kulturale në 2 vitet pas mbjelljes. Këto do të konsistojnë në 2 prashitje, 2 plehërime si dhe 2 vadtje në vitin e parë dhe 1 prashitje, 1 plehërim dhe 1 vadtje në vitin e dytë. Prashitja do të bëhet me rreze 0.3 m nga fidani në një thellësi 10-15 cm. Koha e kryerjes së prashitjeve do të jetë periudha Qershor - Gusht 2025 dhe Qershor 2026. Vadtja rekomandohet të kryhet gjatë mbasdites kur temperaturat kanë rënë në mënyrë që gjatë gjithë natës të thithet nga sistemi rrënjor dhe fidani të ketë rezervë lagështie të mjaftueshme. Vadtja kryhet duke shfrytëzuar ujin e rezervuarit Letaj që ndodhet shumë pranë. Objekti duhet të mbrohet nga kullotja dhe në rast të shfaqjeve të dëmtuesve apo sëmundjeve duhet të bëhet luftimi kimik i tyre. Rekomandohet që të vendoset një tabelë ku të shkruhet "Objekt Pyllëzimi".

KAPITULLI IV

4.1 Analiza e Riskut



Reziqet më të mëdha në zënien me sukses të fidanëve janë:

- cilësia e punimeve (hapja e gropës) dhe fidanëve të përdorur në pyllëzim;
- mënyra e ngjeshjes së dheut dhe mbjellja e fidanëve në gropa;
- kushtet ekstreme të motit (ngricat ose valët e të nxehtit);
- kullotja e bagëtive;
- dëmtimi i qëllimshëm;
- zjarret.

Aktivitetet	Rreziku i identifikuar	Propabiliteti që të ndodhë (U/M/L)	Impakti Riskut (U/M/L)	Masat për zbutjen	Masa shtesë
Punimet përgatitore dhe të mbjelljes në objekt	Cilësia e punimeve (hapja e gropës) dhe fidanëve të përdorur në pyllëzim	M	L	Ndjekja e punimeve me korrektësi sipas projektit	
	Mënyra e ngjeshjes së dheut dhe mbjellja e fidanëve në gropa	M	M		
	Kushtet ekstreme të motit (ngricat ose valët e të nxehtit)	L	L	Njohja paraprake me kushtet e motit	
				Ndalimi punimeve kur moti është i papërshtatshëm	
	Kullotja e bagëtive	L	L	Ruajtja e objektit	
				Komunikimi me barinjtë	
				Mundësi për sigurimin alternativ të bazës ushqimore	
	Dëmtimi i qëllimshëm	M	L	Ruajtja e objektit	
				Ndërgjegjësimi i komunitetit	
	Zjarret	M	L	Ruajtja e objektit	
				Ndërgjegjësimi komunitetit	

Shënim: U-i ulët; M-mesatar; L-i lartë

4.2 Qëndrueshmëria e projektit

Qëndrueshmëria për aktivitetet e propozuara do të varet nga:



- cilësia e punimeve të mbjelljes dhe shërbimeve kulturore;
- ruajtja e objektit nga rreziqet e mundshme.

Në sajë të bashkëpunimit midis stafit të bashkisë Has, kompanisë zbatuese të punimeve dhe përfaqësuesve të komunitetit, do të bëhet e mundur zënia e fidanëve dhe krijimi i grumbullit të ri. Ky plantacion do të krijojë një habitat të mirë për faunën, si dhe do ndikojë në stabilizimin e tokës nga erozioni, si dhe rritjen e stokimit të karbonit. Gjatë zbatimit të punimeve do të angazhohen në këto punime anëtarë të komunitetit të zonës, të cilët me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në këtë aktivitet do të tregojnë edhe interes në ruajtjen e objektit.

4.3 Ndikimi Social Ekonomik

Ky projekt pritet të ketë ndikim social ekonomik në komunitet në disa aspekte kryesore:

1. Krijimi i vendeve të punës: Punëtorët që do angazhohen mund të jenë sezonalë ose të përhershëm dhe do të jenë të punësuar nga fshatrat Letaj dhe Peraj, të cilët ndodhen pranë zonës së projektit. Numri i ditëve të punës për pyllëzimet, zëvendësimet dhe shërbimet kulturore do të jetë gjithsej **335** ditë pune:
 - pyllëzimet 169.6 ditë pune
 - zëvendësimet 15.9 ditë pune
 - shërbimet kulturore (2 vjet): 149.5 ditë pune

Fuqia punëtore e nevojshme do të jetë **10 puntorë** për një periudhë 1 mujore. Në këtë mënyrë nga zbatimi këtyre punimeve, banorët lokalë do të sigurojnë përfitime ekonomike nëpërmjet punësimit të tyre duke kontribuar në ekonominë e tyre familjare.

2. Përmirësimi i kushteve mjedisore: Pyllëzimi ndihmon në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ruajtjen e biodiversitetit, duke ndihmuar në krijimin e një mjedisi më të shëndetshëm për komunitetin.
3. Edukimi dhe vetëdijësimi: Aktivitetet e pyllëzimit mund të shërbejnë si një mundësi për edukimin e komunitetit rreth rëndësisë së mbrojtjes së natyrës dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve.
4. Përfitime ekonomike: ngritja e një grumbulli pyjor sjell përfitime të ndryshme nga prodhimet drusore dhe jo drusore ose mundësi për turizëm ekologjik.
5. Forcimi i bashkëpunimit lokal: projekti mund të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet banorëve dhe institucioneve për zhvillimin e qëndrueshëm;
6. Rritja e vlerës së pronës: një ambjent më i gjelbër mund të rrisë vlerën e pronave në zonë, duke sjellë përfitime ekonomike për pronarët.

4.4 Buxheti i Planifikuar

Hequr nga dokumenti origjinal



4.5 Bilanci ekonomik

Përfitimet që do të sigurohen nga pyllëzimi sipërfaqes janë të shumta, por jo të gjitha janë të mundshme për t'u vlerësuar në terma monetare. Kështu disa nga këto përfitime janë:

- materiali drusor;
- sekuestrimi i CO₂;
- rregullimi i klimës;
- rregullimi regjimit dhe cilësisë së ujrave;
- frenimi erozionit.

Nje pjese e informacionit eshte hequr nga dokumenti origjinal

4.6 Vlerësimi dhe Monitorimi

Për vlerësimin dhe monitorimin e këtij projekti pyllëzimi, qëllimi kryesor është rritja e mbulesës së tokës dhe rehabilitimi i ekosistemit. Për të vlerësuar suksesin e projektit do të përdoren disa tregues, të cilët përfshijnë: (i) shkallën e zënies së fidanëve të mbjellë; (ii) rritjen e biomasës; dhe (iii) diversitetin e specieve.

Monitorimi do të kryhet nga anëtarë të projektit dhe ekspertë të jashtëm me një plan që parashikon vlerësim çdo 6 muaj në vitin e parë dhe çdo vit pas tij. Të dhënat do të mblidhen përmes vëzhgimit të shëndetit të fidanëve dhe ndikimeve të jashtme. Analiza e këtyre të dhënave do të ndihmojë në vlerësimin e progresit, me raportime të rregullta për organizatën financuese të këtij projekti. Përshtatja e strategjive do të bëhet në bazë të rezultateve të monitorimit për të siguruar suksesin e projektit.


4.7 Kuotimi për bazën materiale

Hequr nga dokumenti origjinal




KAPITULLI V (ANEKSE)

Harta e ekonomisë pyjore Helshan




Plani i Mbarështrimit të Pyjeve dhe Kullotave
Shtator 2021

Legjenda	
* Sipërfaqet Provi	Zonat e Mbrojtura
* Qendrat e Banuara	Kufiri i Ekonomisë Pyjore
* Lartësitë	Kufiri i Parcelës
Rrugë Kryesore	Kufiri i Nënparcelës
Rrugë Pyjore	Trupat Ujore
Rrjedhjet Ujore	






5.1 Imazhi në Google Earth i vendndodhjes dhe kordinatat gjeografike të objekteve të pyllëzimit





Imazhet në Google Earth dhe koordinatat e poligonit të objektit 1 dhe 2



Pika	X (V)	Y (L)	Pika	X (V)	Y (L)
1	42°17'42.1 6"	20°22'34.1 3"	1	42°17'39.6 0"	20°22'33.9 6"
2	42°17'41.6 4"	20°22'35.0 4"	1	42°17'39.5 3"	20°22'33.3 4"
3	42°17'41.4 4"	20°22'35.8 8"	2	42°17'39.8 2"	20°22'32.9 8"
4	42°17'41.6 6"	20°22'36.3 9"	2	42°17'40.1 0"	20°22'32.9 6"
5	42°17'42.1 8"	20°22'39.2 9"	2	42°17'40.3 5"	20°22'32.7 0"
6	42°17'41.9 6"	20°22'39.7 9"	2	42°17'40.3 0"	20°22'32.0 6"
7	42°17'41.2 8"	20°22'39.8 3"	2	42°17'40.3 9"	20°22'31.6 7"
8	42°17'41.0 7"	20°22'39.6 0"	2	42°17'40.3 3"	20°22'31.3 2"
9	42°17'41.0	20°22'38.9	2	42°17'40.0	20°22'30.8



	5	6"	6	0"	1"
1	42°17'41.0	20°22'38.3	2	42°17'39.9	20°22'30.4
0	7"	6"	7	1"	6"
1	42°17'41.0	20°22'37.7	2	42°17'39.9	20°22'29.7
1	1"	0"	8	6"	2"
1	42°17'40.8	20°22'37.3	2	42°17'40.0	20°22'29.4
2	2	5"	9	3"	7"
1	42°17'40.4	20°22'37.2	3	42°17'40.5	20°22'29.1
3	4"	8"	0	6"	1"
1	42°17'39.6	20°22'37.4	3	42°17'41.0	20°22'29.0
4	6"	8"	1	9"	1"
1	42°17'39.4	20°22'36.6	3	42°17'41.5	20°22'29.1
5	1"	4"	2	1"	9"
1	42°17'39.7	20°22'35.8	3	42°17'42.0	20°22'30.2
6	3"	2"	3	2"	4"



1	42°17'39.7	20°22'34.7	3	42°17'42.1	20°22'31.9
7	5"	2"	4	9"	7"

Pika	X	Y	Pika	X	X	Pika	X	X
------	---	---	------	---	---	------	---	---




	(N)	(E)		(N)	(N)		(N)	(N)
1	42°18'0.36"	20°22'40.18"	17	42°17'57.63"	20°22'42.16"	33	42°17'58.57"	20°22'40.86"
2	42°18'1.89"	20°22'41.32"	18	42°17'57.09"	20°22'41.97"	34	42°17'58.87"	20°22'41.21"
3	42°18'1.46"	20°22'41.86"	19	42°17'57.04"	20°22'41.72"	35	42°17'58.74"	20°22'41.50"
4	42°18'0.70"	20°22'42.15"	20	42°17'57.07"	20°22'41.29"	36	42°17'59.05"	20°22'41.60"
5	42°18'0.08"	20°22'42.54"	21	42°17'56.83"	20°22'40.57"	37	42°17'59.17"	20°22'41.39"
6	42°18'0.36"	20°22'43.06"	22	42°17'56.60"	20°22'40.25"	38	42°17'59.93"	20°22'41.48"
7	42°17'59.87"	0°22'43.37"	23	42°17'56.36"	20°22'40.03"			
8	42°17'59.58"	20°22'42.88"	24	42°17'56.07"	20°22'39.59"			
9	42°17'59.46"	20°22'42.44"	25	42°17'56.18"	20°22'39.31"			
10	42°17'59.12"	20°22'42.33"	26	42°17'56.73"	20°22'38.81"			
11	42°17'58.83"	20°22'42.59"	27	42°17'57.59"	20°22'40.05"			
12	42°17'58.94"	20°22'42.87"	28	42°17'57.82"	20°22'39.70"			
13	42°17'58.85"	20°22'43.01"	29	42°17'57.95"	20°22'39.81"			
14	42°17'58.57"	20°22'42.91"	30	42°17'58.34"	20°22'40.73"			
15	42°17'58.33"	20°22'42.60"	31	42°17'58.27"	20°22'40.96"			
16	42°17'58.01"	20°22'42.44"	32	42°17'58.43"	20°22'41.05"			

5.2 Foto dixhitale të objektit





5.3 PLANIMETRIA E PARCELËS, NËNPARCELËS

<i>Planimetria e parcelës, nënparcelës</i>	<i>Skema e mbjelljes brenda ngastrës</i>
	Skemë e çrregullt